



UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 01/2008-KRPP

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 2003/2 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Ligjin Nr. 2003/17 për Prokurimin Publik në Kosovë, Rregulloren Nr. 2007/20 për Shpallen e Ligjit me të cilin ndryshohet Ligji Nr. 2003/17 për prokurimin Publik në Kosovë, Udhëzimin Administrativ 2008/1, Fillimi i Vitit Fiskal 2008, të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të Kosovës, lëshon këtë Udhëzim Administrativ

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është që për të gjitha organizatat buxhetore, duke përfshirë këtu Ministrinë, komunat dhe agjencitë e rezervuara, të ipen sqarime lidhur mundësinë e fillimit të aktiviteteve të prokurimit publik bazuar nga fondet e akorduara me ligjin për përvetësime si dhe me pagesat e mjeteve financiare nga fondet e zotuar.

Neni 2

Definicionet

Sipas LPP "**Aktiviteti i prokurimit**" do të thotë çdo aktivitet që ndërlidhet me fillimin ose ekzekutimin e një procedure ose aktiviteti tjetër që shpie ose që ka për qëllim të shpie drejt dhënies së një kontrate publike.

Me "**Fonde të akorduara**" nënkuptojmë fondet e akorduara ashtu siç janë definuar në nenin 32.1 të Ligjit Nr. 2003/2 Për menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Me "**Ligjin për përvetësime**" nënkuptojmë Ligjin që e miraton Kuvendi i Kosovës dhe që i jep kompetenca organizatave buxhetore për të shpenzuar fonde publike, deri në një kufi të caktuar dhe për qëllime të caktuara, gjatë vitit fiskal, siç janë definuar në nenin 1 të Ligjit Nr. 2003/2 Për menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Me "**Ndarje buxhetore**" nënkuptohet shuma e autorizuar me ligj e cila mund të vihet në dispozicion të Autoritetit Kontraktues për shpenzime nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës, ashtu siç është definuar edhe në Udhëzimin Administrativ 2008/1.

Me "**Zotim**" nënkuptohet veprimi formal i ndarjes së mjeteve për një shpenzim që synohet të bëhet, ashtu siç është definuar në Udhëzimin Administrativ 2008/1.

Me "**Shpenzim**" nënkuptohet shuma e parave të paguara nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, ashtu siç është definuar në Udhëzimin Administrativ 2008/1.

Me "**Alokim**" nënkuptohet shuma zotimeve dhe e shpenzimeve që mund të bëhen nga një ndarje specifike buxhetore, ashtu siç është definuar në Udhëzimin Administrativ 2008/1.

Me “**Obligim**” nënkuptohet marrëveshja ligjore, siç është kontrata ose urdhër blerja, me të cilën organizata buxhetore ka hyrë në obligime, dhe e cila kërkon që organizata buxhetore të bëjë një shpenzim në të ardhmen, ashtu siç është definuar në Udhëzimin Administrativ 2008/1.

Neni 3

Interpretimi zyrtar i LPP-së lidhur me fillimi e aktiviteteve të prokurimit publik

3.1 Neni 8.1 i Ligjit për prokurim Publik të Kosovës thotë se “ para së të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti ose procedure të prokurimit që ka për qëllim blerjen e çfarëdo produkti, shërbimi ose pune, autoriteti kontraktues duhet të bëjë një vlerësim formal të nevojave lidhur me këto”.

3.2 Nenin 8.2 i Ligjit për prokurim publik kërkon që “pas vlerësimit të nevojave, autoriteti kontraktues do të garantoj se fondet për prokurimin përkatës janë akorduar në shumën që është e mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve që mund të lindin gjatë vitit fiskal (viti kur ushtrohet aktiviteti i prokurimit në fjalë) si pasoj e prokurimit të tillë”.

3.3 Që të dy nenën të mësipërme të Ligjit për Prokurim publik të Kosovës duhet të interpretohen në kuptimin vijues:

Organizatat buxhetore **duhet të sigurojnë që ekziston ndarja buxhetore apo që kanë besim të arsyeshëm se do të marrin fondet para se të kenë kompletuar procesin e prokurimit**. Organizatat buxhetore mund të ndërmarrin të gjitha aktivitetet e nevojshme të prokurimit para kontraktimit apo krijimit të ndonjë obligimi për qeverinë, **në bazë të ndarjes buxhetore, apo bazuar në besimin e arsyeshëm për pranimin e fondeve, sipas Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) si dhe buxhetin e vitit fiskal 2008**, ashtu siç shkruan në Udhëzimin Administrativ 2008/1, të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa .

3.4 Megjithatë Autoriteti Kontraktues, përkatësisht një zyrtar i angazhuar në prokurim ose në nënshkrimin e kontratave për mallra dhe shërbime pa i zotuar së pari fondet do të dënohet sipas ligjit. **Kjo do të thotë se nuk do të nënshkruhet asnjë kontratë për krijimin e obligimeve para se të bëhet zotimi i fondeve në sistemin Informativ të menaxhimit Financiar**, ashtu siç shkruan në Udhëzimin Administrativ 2008/1, të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa.

3.5 Autoriteteve Kontraktuese me këtë Interpretim Zyrtarë iu mundësohet që duke marrë parasysh planin rrjedhës buxhetor përkatësisht Projektet Investive Publike (PIP) të aprovuara fillimisht nga Departamenti Buxhetit të Kosovës dhe të përfshira në Kornizën afatmesme të shpenzimeve (KASH) si dhe Buxhetin për vitin fiskal 2008, të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, do të mund të fillojnë procesin e prokurimit duke qenë të sigurt se fondet për projektet përkatëse do të jenë të siguruara, por asnjëherë nuk do të kenë të drejtë që të nënshkruajnë kontratën me Operatorin Ekonomik pa u siguruar se ato fonde janë zotuar në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Thesarit .